

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

DHE

QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

QSPA

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve e për Arbëreshët

PREAMBUL

Akademia e Studimeve Albanologjike dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët në Ministrinë e Diasporës, të cilat në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë e rritjes të cilësisë së kërkimit shkencor në fushën e historisë, letërsisë dhe kulturës së komunitetit arbëresh;

Për të evidentuar kontributin që ka komuniteti arbëresh në ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare;

Me dëshirën për të nxitur studimet dhe publikimet kërkimore shkencore dhe rritur cilësinë e tyre duke përfshirë akademikët dhe studiuesit e fushës;

Me synimin për të koordinuar aktivitetin, studimet dhe standardizimin e kërkimit shkencor në vlerësimet e përbashkëta;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe realizimin e studimeve në nxitjen e mendimit shkencor të specializuar për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Ato do të koordinojnë veprimtarinë e tyre duke i dhënë një rëndësi të veçantë hulumtimit, vlerësimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të kulturës arbëreshe si një ndër dëshmitë historike më shprehëse të identitetit shqiptar.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Neni 2 Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Kryerjen e studimeve dhe botimeve të ndryshme të përbashkëta mbi historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh;
- b. Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- c. Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm;

Neni 3 **Përgjegjësitë e palëve**

Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi do të funksionojë si vijon:

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët do të realizojë:

- a. Financimin e studimeve të specializuara mbi historinë dhe kulturën arbëreshe;
- b. Botimin e studimeve të kryera për fushat e sipërpërmendura;
- c. Realizimin e aktiviteteve vjetore dhe konferencave shkencore me fokus komunitetin arbëresh;

Akademia e Studimeve Albanologjike do të realizojë:

- a. Bashkëpunimin midis Institutit të Antropologjisë Kulturore si pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët në fushën e etnologjisë, folklorit dhe artit arbëresh;
- b. Bashkëpunimin midis Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë si pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët në studimin e dialektit/gjuhës arbëreshe si dhe vendosjen në dispozicion të kësaj të fundit të kartotekës dhe fonotekës së dialektologjisë shqipe për qëllime studimore, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren për shfrytëzimin e tyre;
- c. Bashkëpunimin midis Institutit të Historisë si pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për vendosjen në dispozicion kësaj të fundit të fondeve arkivore për qëllime studimore, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren për shfrytëzimin e tyre.
- d. Bashkëpunimin mes Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare si pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me qëllim hartimin dhe botimin e enciklopedisë arbëreshe;
- e. Ofrimin e ekspertizës për realizimin e studimeve dhe publikimeve për arbëreshët nga QSPA-ja, për të siguruar cilësinë e kërkimit shkencor si dhe mbështetjen e vazhdueshme të studiuesve të rinj në këtë fushë;
- f. Bashkëpunimin për botimet në revistat shkencore, që Akademia e Studimeve Albanologjike dhe institutet e saj përbërëse i publikojnë periodikisht, të studimeve të QSPA-së.

Neni 4

Zbatimi i memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë një viti kalendarik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren bashkërisht rast pas rasti.
3. Me nënshkrimin e këtij memorandum, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka të drejtë të komunikojë drejtpërdrejtë me secilin institut/qendër të Akademisë së Studimeve Albanologjike për bashkëpunime konkrete, por në çdo rast do të informojë rektorin e Akademisë së Studimeve Albanologjike si autoriteti më i lartë i këtij institucioni dhe përfaqësues i tij me të tretët.

Neni 6

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion, ose që QSPA-ja siguron përmes donacioneve apo projekteve të fituara.

Neni 7

Kohëzgjatja e dhe ndryshimi

Ky memorandum nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ai mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9

Hyrja ne Fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe dy pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Nënshkruar në Tiranë, në 2020.

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
REKTOR
MARENGLLEN VERLI

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN
PANDELI MAJKO

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT
DREJTOR
DIANA KASTRATI